GJUHA "BARBARE - E PAR PARE" PELLAZGO-SHQIPE SHPËTUESE E GJUHËVE CIVILE

Shqipja, çelës që dijetarët e dinë, e s'duan të hapin dyert e botës.[1]

Sikur të ngelen 785 fjalë të thjeshta të shqipes, gjuha e botës fillon nga e para.[2]

PELLAZGËT KANË FOLUR DHE SHKRUAJTUR SHQIP

Do vijë një ditë që bota e qytetëruar do të hapë letrat e do tronditet thellë për trajtimin që i ka bërë racës së parë mbarë-njerëzore, stërnipër e stërgjyshër, që për fatin e saj flasin akoma gjuhët e tyre.[3]

Ne gjeologët, ndryshe nga shumë shkenca të tjera, mundohemi të zbërthejmë të brendshmen me anë të sipërfaqes, ose e thënë ndryshe, thellësinë me anë të cektësisë, për të arritur te ajo që nuk duket ose te ajo që fshihet. Sepse e tillë ka qenë edhe historia e të parëve të njerëzimit pas përmbytjes së madhe apo pas akullnajimit të fundit apo pas hirit të fundit të madh vullkanik. Ata shkruan, punuan e lanë gjurmë në shumë forma, që të mëvonshmit, nëse do të ishin mosmirënjohës, një ditë në dritë do ta nxirrnin të vërtetën e themelimit të diturisë së njerëzimit.

Fig. – 1 *Pllaka të shkruajtura qysh në agimet e shkrimeve të paratë nerëzimit, ku njeriu parak ka lënë diturinë dhe ligjësitë e natyrës*

Ndaj, shkruan, edhe mbi pergamene, edhe mbi pllaka varri, edhe mbi papiruse dhe mbi pllaka të pjekura argjile (*Fig.- 4)*, që nëse disa nga këto shkatërroheshin me acid, me dalta e çekiçë sikundër ka ndodhur me varret ilire në Bosnje e Serbi, koha do të zhvarroste 90,000 pllakat shumere apo ato 12,000 etruske deri te disku i tejpjekur i festos, të cilët i kanë rezistuar vullkaneve, zjarreve apo përmbytjeve e tërmeteve.

Dhe me pak kujdes e dëshirë vëren se ka boll fakte, dokumente dhe interpretime, që të kuptosh se gjuha e historisë civile nuk nis me kohën e të fortëve të s aj (Helenë, Romak), madje as me atë të dokumentuar në historinë arkaike, si atë shumere, babilonase, egjiptiane, izraelite, por ajo zanafillon qysh herët, pikërisht atëherë, kur njeriu identifikonte veprimet, sjelljen e tij apo të botës përreth me

[1] *Sazan GURI, Parathënie e librit të prof. Muharrem Abazaj "Shqiptarët kanë shkruajtur dhe folur shqip", v. 2013*

[2] *Johann George von HAHN, Albanesiche Studien, v.1854*

[3] *Një nga profecitë e Nostradamit,*

Qendra Kombëtare "RRËNJËT TONA" , Rr. Zef JUBANI, Pall.Bjorn, Ap. 62, K-8, Tiranë, tel: 0682070560,
email: sazanguri@gmail.com, web: wwwrrenjettona.al

gjurmën apo jehonën që ato linin në natyrë. Historia arkaike, por sidomos ajo e të fortëve, thjesht e përpunoi e zgjeroi - në shumë raste e zbukuroi, le të themi e roman(t)izoi, e pol(h)enizoi, por poezinë, prozën, gjenin, më saktë, farën e saj, nuk ka guxuar dot kurrsesi t'ia shformojë.

Dhe pikërisht këtë risi na sjellin plot studiues si zonja Nermin Vlora,[4] i madhi i ditëve tona etruskologu Niko Stillo, gjuhëtari fort i duruar e plot pasion Muharrem Abazaj, që nuk rreshtin së lexuari terrakota e pllaka deri në gurë varresh të hapërdara në trevën apo ngulmimet proto-evropiane, që sot në mënyrë alternative thirren nga shumëkush vendas e të huaj si sumerë, babilonas, izraelitë, helen, romak dhe nga pak kush vendas e të huaj si pellazgë, trakë, ilirë, epirot, etrusk, toskan, arban, shqiptarë. Ja, këtu mëshon puna e këtyre profesorëve, jo për nga titulli që nuk kanë, por për nga puna akademike, si i thonë fjalës, që kanë lënë. "Po pse", do thoni ju, i dashur lexues? Sepse, si jo shumë të tjerë, ata kanë mundur që pllaka apo shtylla si mbishkrimi e Lemnosit të flasë pellazgjisht[5], duke e lexuar sa djathtas, sa majtas, sa nga lart e sa nga poshtë, dhe së fundmi na dhurojnë ndryshe nga të tjerë, një ngjarje më pranë të vërtetës, më afër formës së figurës dhe më brenda kontekstit historik[6].

Dhe këtë armë, këtyre dijetarëve ia u jep nyja gordiane, ajo e zbërthimit të shkrimit të këtij lapidari, sikundër kanë bërë dhe për mbishkrimet e tjera, me anë të gjuhës njërrokëshe, të asaj bruto, të asaj të pazgjatur me para e pasthirrma heleno-romake, të asaj që Zoti ja caktoi këtë fat vetëm një kombi, që për hatër të misionit, ndërroi pushtues e fe, por jo gluhën e aglutinuar apo të ngjitur në dhé. Mbishkrimi i Lemnosit përbën dokumentin e parë të qartë të shkrimit pellazgjik të shpëtuar deri më sot. Ai ka shërbyer si bazë për të njohur më tej gjuhën e shkruar pellazgjike. Alfabeti i këtij mbishkrimi është i përafërt me alfabetin fenikas. Si askush tjetër, prof. Abazi na jep zbërthimin e pllakës[7]:

sesi një person ka zaptuar tokën e një tjetri; aty vjen pronari legjitim i tokës dhe i kërkon atij të largohet që andej, t'ia kthejë, pasi fisi i tij e ka të trashëguar atë brez pas brezi; zaptuesi nuk pranon t'ia kthejë; pas pak aty vjen edhe vëllai i pronarit të tokës; edhe ai deklaron se tokën e kanë të trashëguar nga nëna; i kërkojnë përsëri zaptuesit t'ua kthejë; ai përsëri refuzon; vëllezërit deklarojnë se nuk largohen që aty; ata thonë se me atë rrojnë, aty hapin edhe varret; pas refuzimit për herë të fundit nga zaptuesi, ata sikur flasin shqipen e sotme thonë:

---

[4] ***Ajo ka botuar 25 libra, poezi, romane e saga**. Në Kolumbi, ku ndenji rreth 5 vjet, ka botuar 3 libra mbi qytetërimin parakolumbian–Kibka. Për këtë u emërua prej qeverisë kolumbiane si Person i Urdhrit të Shën Karlit. Studion për rreth dhjetë vjet me imtësi e me rezultatet e duhura paleografinë euro–mesdhetare. Shërben si anëtare tri herë në Akademinë e Italisë.*

[5] *Nermin Vlora FALASCHI, Prona Gjuhësore dhe Gjenetike, fq. 68 , v. 1997*

[6] *Muharrem ABAZAJ, Pellazgët kanë shkruajtur e folur Shqip, fq. 134, v. 2014*

[7] *Po aty,*

Lotaiezihokiasiape zeronaipefis tiferona - Lot ai e zi hoki as i ape. zero na ip e fis fer ona - thikë na hoqe, ti na there.

Fundi tragjik i këtij konflikti pasqyrohet edhe nga portreti i dëshpëruar i heroit të gdhendur në gur, por edhe nga prania për krah tij e një thike.

Fig. – 2 *Shkrime në gur dhe në pllaka të pjekura argjile, si një nga format e shkrimeve, ku njeriu parak i ka shkruajtur për të përjetësuar misionin e vet, që nëse sulmohej kultura e të parëve, këto të zbuloheshin nga pluhuri e të na rrefenin historinë dhe gjuhën e tyre.*

Si për të na bindur edhe më, se këto pllaka (Fig.–5), kudo që ndodhen në trevën pellazgjiane lexohen vetëm nëse di gjuhën e njerëzve të para hënës, autorët na sjellin mbishkrime të gjetura në Greqi, në ishullin e Kretës, në vendin e quajtur Tirinth, i datuar si i shek. VI. p.e.r., i shkruar në stilin bustofedik, njësoj si ai që është përdorur në mbishkrimin e Lemnosit, megjithëse alfabeti i përdorur këtu ka disa luhatje krahasuar me atë të Lemnosit. Ky fakt shtron përpara një çështje tjetër të rëndësishme për akademikët tanë, ku na duhet të na thonë se kemi alfabet fenikas apo pellazg, apo kemi të bëjmë me të njëjtin alfabet? Edhe ky lapidar flet për një acarim-konflikt midis dy personave, që për mendimin tonë ka qenë midis levendasit (pellazgut) dhe ardhësit (dorëve apo eolianëve), e cila çoi në një fund tragjik. Kjo kuptohet nga fakti që ngjarja është përjetësuar në një mbishkrim të tillë me konflikt pronësie. Kjo nuk është rastësi, sepse pellazgët kanë qenë shumë të lidhur me tokat, me pronat e tyre, pasi siç e pamë tek Lapidari i Lemnosit, "*me atë rrojnë, atje hapin varret*". Psikologji dhe filozofi që shoqëron kahershëm këtë komb deri në ditët e sotme.

Si për të na bindur me vërtetësinë e zbërthimit të këtyre pllakave, ata nuk ndalin së varrmihëri edhe pllakat e tjera në trevat e banuara nga etruskët (njerëzit me tru), si atë të deshifrimit të mbishkrimit "Tavola di Cortona". Ky mbishkrim (Fig. – 6) është rigjetur në vitin 1992 në Cortonia, në zonën e Piagie di Comucia, në provincën Arezzo të Italisë, e cila mendohet se i përket shek. III-II p.e.r. Ai është i ndarë në tetë pjesë, ku pjesa e fundit është tërësisht e dëmtuar, e cila nuk na lejon të zbulojmë plotësisht përfundimin e ngjarjes. Por, me sa zbërthen autori[8] në shtatë vajet (ligjërimet e para apo të qarat me ligje, ajo do të ketë patur një fund tragjik, për derisa ngjarja është përjetësuar.

Fig. – 3 *Pamje të shkrimeve piktograma, si bazë e shkrimeve dhe alfabetëve të mëvonshëm të njeriut parak.*

Ka shumë mundësi që babai në këto vaje, pasi të ketë zbuluar veprimin e keq të të birit, i cili do ta ketë ndalur qëllimisht rrjedhën e ujit të përroit, për

[8] *Po aty,*

të fajësuar skllavin, do të jetë treguar i pamëshirshëm ndaj të birit, ndaj dhe më pas nëna apo gratë, siç bëjnë sot gratë himarjote apo labe, e kanë qarë me "oi", me voje apo vaje. Po në këtë trevë, me anë të gjuhës së të parëve tanë, një nga këta dijetarë, si prof. Muharremi vazhdon me leximin e *'Mbishkrimit të shkurtër në Viterbo'* (mbishkrimi mbi sarkofag, i vendosur në Muzeun Arkeologjik të Viterbos), ku vërteton edhe një herë sesi e kanë quajtur pellazgët *Hyun e tyre - Zotin*. Dhe autori nuk pushon duke sjellë fakte, siç bën me deshifrimin e "*Pllakës së Pyrgit*", të periudhës së shek VI-IV p.e.s., mbishkrim i shkruar dy gjuhësh në tri fleta ari, me germa të njëjta me atë të alfabetit të Lemnosit. Apo siç bën me pllakën e gurit, mbi të cilën ndodhet mbishkrimi "*Cippo di Perugia*", e gjetur në zonën e San Markos, në rrafshinën e malit Tezio, pranë burimeve të përroit Genne në Peruxhia. Edhe sot, ky përrua me ujë të bollshëm është furnizuesi kryesor me ujë të pijshëm i këtij rajoni.

Ajo që i bën këto pllaka, edhe më të besueshme, është përpjekja e kësisoj dijetarëve për të zbërthyer toponimet e zonave ku gjenden ato, me anë të gjuhës së vetme në rruzull njërrokëshe, duke na dëftyer trinomin komb-gjuhë-objekt. Ndaj, dhe jo rastësisht, emrat toponim të këtyre zonave, si ajo e malit Tezio (Te zi-a, te vendi ku ra zija), ose e Lemnosit (lë emn, për shkak se në këtë vend u bë një gjëmë aq e madhe sa u la emër për të mos u bërë më model i zgjidhjes), etj., s'janë gjë tjetër, veçse emërtime pellazgjike. Madje, autori i sipërmendur para se të vijë te zbërthimet e mbishkrimeve nëpër lapidarë apo shtylla të ndryshme, kudo nëpër treva pellazge të Mesdheut, shpjegon toponimet e zonave krahinave apo qyteteve të banuara prej këtyre parakëve evropianë. Por, më parë akoma, ai i jep kuptim zbërthimit të gjuhës së këtyre parakëve, duke iu referuar, jo pak gjuhëtarëve të Evropës, por edhe duke gjetur çelësin e formimit të saj, si gjuhë e përngjitur sipas shpjegimit origjinal të të parit gjuhëtar albanolog - Franc Boppit. Në bazë të kësaj teorie qëndron ideja se çdo trajtë apo fjalë morfologjike në gjuhët indoevropiane përbëhet nga disa elementë, të cilat e kanë burimin në rrënjë të pavarura. Sipas saj, çdo trajtë foljore, është një fjali në miniaturë, një fjali shumë e vogël. Këtë dukuri, Boppi e vuri re:

në gjuhën shqipe dhe që ende ruhet si dikur[9].

Madje, do shtoja si inxhinier i natyrës (gjeolologji e mjedis), se gjuhës shqipe, i merr kuptim jo vetëm fjala, për të cilën sapo folëm, por edhe trajta e saj njërrokëshe, sepse tinguj që ndërtojnë këtë njërrokësh tregojnë një ndodhi, si p.sh., uji ka qenë emërtuar me një tingull të vetëm, me "*u*", sepse uturin si proces në det apo në lumë apo gurgullon në përrenj, apo folja është/asht me tingullin "*a*", etj. Kjo duhet të lidhet me periudhën njerëzore, qysh pas ciklit të madh akullnajor, kur klima i detyroi njerëzit të jetonin bashkë, diku 22 mijë vjet para Krishtit. Pas përmbytjes së madhe dhe pas hirit të madh vullkanik, diku rreth 12 mijë vjet para Krishtit, njerëzit u detyruan të shpjegonin dukuritë apo fatkeqësitë natyrore, duke iu drejtuar ligjësive të botës së gjallë, pra kafshëve, natyrës, si dhe botës qiellore. Për këtë etapë, ata përdorën procesin e aglutinim/përngjitjes, ku vendosën pranë njëra-tjetrës disa fjalë njërrokëshe. Vonë-vonë, gjuha shqipe filloi të bëhet flektive apo elastike, më saktë akoma, siç thotë i madhi Zheji, gjuhë që i ktheu fjalët në operatorë të lirë, ku fjalët i nënshtroheshin

[9] *Franz BOPP, Ueber das Albanesische, v. 1854*

ndryshimit të tyre sipas kuptimit, ndryshim që realizohet me anë të parashtesave, prapashtesave dhe mbaresave[10]. Por, një gjë është e vërtetë, se njerëzit parak e kanë filluar komunikimin midis tyre me anë të artikulimit të tingujve të veçantë, pastaj të njërrokëshave. Kjo etapë duhet të jetë shtrirë që nga zanafilla njerëzorë dhe do të ketë vazhduar për dhjetëra mijëravjeçarë. Këtë vlerë ka kuptuar autori i këtij libri te gjuha shqipe. Duke qenë gjuhë e izoluar, duke qenë se nuk ka njohur procesin e eptimin (ndryshimit të fjalëve gjatë lakimit dhe zgjedhimit), si e tillë iu jep mundësinë studiuesve, nëse e zotërojnë dhe kuptojnë këtë çelës që të zbërthejnë pllakat shumere, etruske, mbishkrimet e lapidaret, përpos asaj të ardhur me kuvend, lahutë, rapsodi, epope, elegji e ligjërime. Fati dhe faktet të tilla kanë ndihmuar guximtarin, pra dijetarët e mësipërm, që kanë ditur të mbledhin emra lumenjsh, malesh, detesh, kodrash, qytetesh dhe në bazë të rregullave gjuhësore të at'hershme, ata përkojnë jo rastësisht lidhjen që ka objekti me vetinë e vet, kuptimi i të cilave nxirret me anë të pellazgjishtes që është një e folur dhe e shkruar tanë ditën e tanë natën shqip. Ndaj dhe mënyra e parë e shkrimeve ka qenë ajo ideografike, ku bëhej i mundur transmetimi i mendimeve në kohë dhe distancë. Pra, vendosej paralelizmi midis një nocioni apo një fjale me figurën e një objekti konkret të natyrës, që duhet të ketë zënë vend aty rreth 11,000 - 12,000 vjet më parë, pikërisht në momentin, kur njeriu i at'hershëm studionte pas përmbytjes dhe hirit vullkanik, botën astronomike, atë të natyrës dhe atë të kafshëve. Jo rastësisht, emrat e planetëve, shumica e emrave të perëndive, emrave të kafshëve, etj.,[11] përkojnë dhe zbërthehen me anë të gjuhës para hënore, e cila është e stamposur sot në shqipe.



Fig. – 4 *Hieroglifet e para të alfabetit pellazg, që sipas G.Katapanos shërbyen si baza e prodhimit të alfabetëve të mëvonshëm.*[12]

Zgjerimi i njohurive kërkoi mënyrë të re shkrimi, baza e të cilit tashmë ishin hieoroglifet. (*Fig.– 7),* Pra, jo më një figurë të vizatuar, por një shenjë grafike për çdo nocion, për çdo fjalë. Zëvendësimi i figurave me shenja grafike (kombinim vizash) solli përmirësimin praktik të tij (referoju asaj që ka zënë vend në Mesopotami, Egjipt, Indi, Kinë, Kretë e gjetkë), ku dokumentimi më i hershëm është ai *kunieform shumerë*[13]. Me këtë shkrim në formën e kunjave, janë të mbushura një numër i madh pllakash të gjetura në territorin e Mesopotamisë, të cilat datojnë se janë të mijëvjeçarit të IV p.e.r.

[10] *Petro ZHEJI, Shqipja dhe Sanskritishtja, Vol. II, fq. 537, v. 2006*

[11] *Giusseppe CATAPANO, Thoti fliste Shqip, v. 1983*

[12] *Po aty*

[13] *Z. SITCHIN, The Twelfth Planet, NY, USA, fq. 48, v. 1976*

Koha e zbulimeve të mëdha, të lidhjes së shenjave jo më me fjalët, por të lidhjes së shenjave të veçanta me tinguj të veçantë, kërkoi krijimin kështu të një alfabeti, që historia njeh për të parë atë fenikas, duke anashkaluar atë pellazg, i cili shfaqet sa herë kur ajo i ka nevojën. Por, ç'hyn autori në këto vlerësime mbarë botërore për metodikat e shkrimeve? Hyn, sepse ai bëhet pjesë e asaj plejade gjuhëtarësh që para se të lexonte lapidarë, ngriti në lapidarë të kuptuarit sesi shkrimi ideografik, edhe ai hieroglifik, kanë pasur në bazë çiftimin figurë-rrokje dhe hieroglif-rrokje, dhe se ky çiftim përputhet me fjalën njërrokjore pellazge. Kjo përbën shpikjen dhe mekanizmin çelës të zbërthimit të hieroglifëve nga i madhi Katapano, të shkrimeve me kunja nga i madhi Zitchini, punë që po e vazhdon inxhinieri shqiptar A.Shuke, deri te leximi i shkrimeve me alfabet pellazg të pllakave etruske nga i madhi Niko Stillo, Falaksi, dhe së fundi nga prof. Muharrem Abazaj.

Një parim tjetër që përdorin studiuesit shqiptarë të pellazgollogjisë për të lidhur gjuhën shqipe me objektin apo toponimin është edhe rikonstruksioni i brendshëm, ku është pikërisht kjo gjuhë që ruan pjesë fjalish, formash, tingujsh nga trajta e saj e vjetër, me të cilat mund të rindërtohet një e kaluar e plotë e saj. Megjithëse nuk është e lehtë, sepse fjalët pellazge, jo rrallë shfaqen në një trajtë të ngurtë, dhe si të tilla, ato mund të kenë disa kuptime, si rasti i fjalës *di* mund të ketë kuptimin *me ditë*, por edhe *i ditur*, por edhe kuptimin e emrit *dhi*. Kjo të kërkon të kuptosh të tërën ose kontekstin, e pastaj të veçantën apo tekstin. Ky guxim kërkon, jo thjesht dhe vetëm njohuri gjuhësore, por edhe historike, edhe arkeologjike, edhe të jesh njohës i disa gjuhëve të vjetra, por edhe i pajisur me njohuritë bazë antropologjike, deri në ato gjeoshkencore dhe etnografike.

Shumë prej emrave të këtyre toponimeve që mbërrijnë në ditët tona, këta studiues i mbështesin me shpjegime nëpërmjet gjuhës pellazge që nuk ka ndryshim me atë shqipe sot. Si do thoni ju? Ata zbulojnë më parë foljet dhe emrat më të shkurtra ndër gjuhët e botës, si ato *at, am, pi, a (ha), a (asht), zi (zi en, nxin), ik, ip (hip), ra, i (il-ill-yll), i (zot), nin (nie-niej-ndiej-ndigjoj), y (yn-yni-i yni), ur (urt-urtë-të urtë), tan (tërë), li (ri-rri), in (ri-rri), ar (arë-arrë), on (jon-jonë), es (është), va (varr), ir (hir-e), da (nda-ndaj), ro (ron-rron-të rroj), pol (pjell), u (uk-ujk), pul (pulem-pëulem-përulem), ut (ud-udh), bar (bardh),* me të cilat shkruhen pandërprerë këto pllaka, dhe doradorshëm e rrokje-rrokje, ata nuk lodhen të nxjerrin kuptimin e toponimive, pastaj të vajeve e ligjërimeve të stamposura në lëkura, në papiruse, në pergamene e në mbishkrime, që sot figurojnë të zhdukura.

Madje, të asgjësuara me shumë kujdes, qysh prej 26 shekujsh nga klerikë të ndryshëm deri te ajo shtresë injorante e vetë popullsisë pellazge, ilire, trake, arbane, shqiptare që nuk kanë ditur se çfarë kanë pasur nën këmbët e tyre[14] Gjithsesi, parakët tanë kanë arsyetuar edhe për kësi rastesh, kur epopetë, himnet, elegjitë, vajet, jo vetëm i treguan me kangë e rapsodi brezash, por i shkruan nëpër pllaka të pjekura argjile, dhe jo pak, në 12,000 etruske dhe në 80,000 sumere dhe disa dhjetëra gurë e lapidare mbi varre, të pagjetura apo të shpëtuara nga zoti apo natyra, me disa prej të cilave rreken

[14] ***28,000 dorëshkrime*** *janë djegur më 1932 në Manastirin e Apolonisë, Fier. Mos harroni se gjithsej 10,000 dorëshkrime të tilla gjenden në Armeni.*

këta autorë (Fig. – 8). Por, ka raste që autorët tanë mund të mos japin analizën e duhur, si rasti e prof.Muharrem Abazaj për toponimin Kret-a, që ndoshta lidhet me atë që përshkruan autori, si tokë shkëmbore që bie krejt e në det, ose në syrin tonë si tokë që bie me kokë apo me *kre* në det, por më shumë të ngjarë ka që të lidhet me kuptimin si një ndër vendbanimet më të hershme, mbase më i hershmi, i ndërtuar në gjenezat e civilizimit të qyteteve, ndaj thirret Kre(t), si qyteti Pri(shtinë) - qytet që prin, i parë, apo qyteti Nis(h), si qytet që nis si i parë, njësh, apo qyteti Pargë - i parë i gurtë, qytet i parë me gardhe apo Paramithi - i parë më the.

Fig. – 5 *Gurë mbi të cilët janë shkruajtur porositë e të lashtëve apo mësimet e para të njerëzimit, ndaj dhe të diturit në gjuhën parake quhen guru ose mësues.*

Gjithsesi, nga botimet e këtyre studiuesve mjaft të zellshëm, mësohet se pas shek. VI vjen një periudhë, kur mungojnë mbishkrimet nëpër gurë varresh, kohë që përkon me rënien e perandorisë romake, ku gjuha dhe kombi i at'hershëm Ilir - pasardhësi apo vllai i pellazgëve po vuante rënien e shkëlqimit të perandorëve të vet. Pas kësaj heshtje apo errësire vjen diku, në midis shek. XIII-XIV, një etapë tjetër, ku fillon dhe formësohet gjuha flektive shqipe, kur mund të ketë lindur dhe dialekti i toskërishtes. Gjithë librat e tyre të pajisin me përpjekjen e autorëve, të cilat shkojnë në një mendje me ata pak studiues, që veç gjuhës besojnë te elementët e tjerë, madje institucional të vazhdimësisë pellazgo - ilire - thrako - arbane - shqipe, siç është ajo me tokën, me arën, me vatrën apo vatanin, ndaj dhe shumë toponime, ata i shpjegojnë dhe i mbështesin, duke futur konceptin "*ar*" si tokë që ushqen, apo *"di"* si dituri mbi tokën, si mjeshtër të saj. Kësisoj, ata shpjegojnë dhe mbështesin emrat toponime si: Larisa/le në arrë; *Arkadi/Ar-ka-di/arë ka dituri/për arë ka dituri; Epir/*ep-*jep dhe ep-i epërm, i sipërm; ir/hir, hiri i epërm/beklimi i epërm, i lartë" ose ep ~ jep, hir/bekim". Ardian(ë)/ar-arë; di-i ditur; an-janë; Dardan-ndan anë; Desar(etë)/des-ar, des-vdes, ar-*arë, v*des në arë*. Vetë fjala vatan është e lidhur me vendin e varreve. Përbërja e kësaj fjale të përngjitur pellazge është: va-at-an. Fjala e parë va~varr; at~babë; an~janë. "*Varret e etërve janë.*" Por, autorët e zellshëm dhe jo akademik shqiptarë nuk ndalen së analizuari, madje në mënyrë racionale, pse gjuha shqipe mbeti shëmbëlltyra më besnike e pellazgjishtes, madje e vetme në përplasjet e kulturave ndër mijëravjeçarë? Ata na zbulojnë sesi me lindjen e gjuhës greke, në shek. X-VIII para Krishtit, popullsia pellazge në Greqi filloi të diferencohej, ku bazë e këtij diferencimi u bë vetë gjuha. Gjuha e re helene, (Fig. – 7), duke marrë fjalët bazë njërrokëshe, proverbat apo fjalët e urta pellazge të dalë nga një kohë e gjatë, shpikjet bazë, të drejtën zakonore si të gatshme, pasi i llastoi ato me para e pasthirrma, i bëri kështu flektive, aq sa u dha mundësi autorëve grekë të lashtësisë të shpalosnin veprat e tyre të të gjitha fushave. Njohja me këto vepra filloi të tërheqë një masë më të madhe njerëzish, pavarësisht origjinës së tyre, jo vetëm atëherë, por edhe dy shekujt e fundit e deri para disa vjetësh. Kjo bëri që njohja e greqishtes së vjetër të konsiderohej si një mjet për t'u bërë njeri i kulturuar, ku njerëzit dhe kombet evropiane në kërkim të origjinës e lavdëronin këtë periudhë, pa marrë parasysh sesi erdhi vetë ajo. Moda kërkoi që ata, që arrinin ta mësonin greqishten quheshin helenë, njerëz të shkathët, të

hedhur, dhe ata që mbeteshin me atë gjuhë që kishin, thirreshin fshatarë, të pagdhendur, malok, aq sa i pari dijetar Herodoti e la të shkruar se[15]:

"*gjuha përreth asaj helene, pra ajo pellazge është një gjuhë barbare".*

Ajo mbijetoi vetëm në krahina të thella, larg qendrave të qyteteve helene në shkëlqim, larg shkollave e akademive të hapura helene, larg klubeve e shoqatave helene. Që të bindesh për këtë, i dashur lexues, imagjino që "*akademi*" quhej një vend-tokë pranë qendrës së Athinës, i pasur me "*ka*"', "*buaj*" e "*dema*", ku filozofi Platon ngriti një shkollë në këtë fushë, dhe e quajti "*Akademi*", pastaj kjo fjalë u kthye në titull për ata që mbarojnë këtë shkollë, e sot thirren akademikët. Dhe termi barbar, duke filluar me Herodotin, iu qep pas gjithë atyre, që pasi iu merrej fjala, gjuha, shpikja, proverba, urtësia, mençuria, perëndia, kulti, etj., i jepej shqelmi, i vihej çekani nëpër gurë varresh, i digjeshin shkronjat nëpër papiruse, pergamene, lëkurë dhie e viçi. Ndërkohë që duhet të ketë qenë e vërtetë, siç thotë Herodoti, problemi i pakësimit numerik të pellazgëve, jo se ata nuk shtoheshin, por ritmi i shtimit të helenëve ka qenë më i madh, sepse pellazgët po kryenin misionin e tyre nga Zoti, që të shërbenin si protoplazma për kombet e tjerë. Por, jo se pushoi së rrituri, siç thotë Herodoti,[16] sepse ajo ishte farë, tashmë e shpërndarë deri në kufijtë me Indinë, deri në kufijtë e Afrikës Veriore deri në rrëzë të maleve Kaukazë, aq sa pushtoi Aleksandri i Madh, aq sa pushtoi perandoria Romake, aq sa u shtri perandoria e Bizantit dhe aq sa u përhap perandoria osmane me bazë popullsie Hitite, aq sa shkuan si Pirro Burri i Epirit dhe Skëndërbeu për ndihmë tej Adriatikut, dhe as që mund të mendohet që ajo racë njerëzore, "*fara*" e racës së bardhë të pushonte shumëzimin e saj natyral.

Ndërkohë që kjo gjuhë vazhdoi të mbetej e tillë deri në mes të mijëvjeçarit të parë, edhe në ato vende, ku shtrihej ndikimi romak. Dhe autorët e kësaj periudhe, banorët e këtyre vendeve që faktikisht populloheshin nga pellazgët dhe flisnin gjuhën e tyre, gjene i quanin barbarë. Dhe këtë etiketim nuk e shohim tek ndonjë autor i veçuar, por gati tek të gjithë autorët e lashtësisë pa përjashtim. Dhe jo vetëm tek autorët grekë, por më vonë, edhe tek ata latinë. Le ta nisim me Tukididin, si pasardhësi më i afërt i Herodotit, i cili shkruan:

"*Atëherë (epidamnisit) që ishin në qytet, me qenë se ishin zënë ngushtë, dërguan delegatë në Korkyrë, si qytet mëmë që e kishin, duke u lutur që të mos rrinin të paanshëm ... dhe t'i jepnin fund luftës së barbarëve*."[17]

Për shtrirjen në jug të barbarëve (pellazgë/ilirëve) flet edhe Tukididi që shkruan*:*

---

[15] *Herodoti, Historia, Libri VIII,*

[16] *Megjithëse,* ***Herodoti edhe mund të merret me rezervë*** *sipas studiusit gjerman, për të cilin thot se Herodoti vetëm dhe vetëm gënjen, madje citon shumë raste ku pikëpamjet e të ashtuquajturit babait të historisë i kalojnë kufijtë e së vërtetës. Arsim SPAHIU, Shteti Epirot, fq. 8, v. 2011*

[17] *Thuqididi, Historia e Luftës së Peleponezit,*

"Helenët marshonin të rreshtuar në formacion ushtarak ... deri sa ngulën lëmin në një vend të përshtatshëm. Kaonët, përkundrazi ..., nuk u ndalën për të ngritur lëmin, por duke shkuar me vrull përpara, bashkë me barbarët e tjerë, llogaritnin të merrnin qytetin"[18].

J. Çezari, i cili jetoi në shekullin e fundit të erës së vjetër, shkruan:

"*Kur u larguan nga Iliria anijet liburne, M.Oktavi ... nxiti dalmatët e të tjerë barbarë dhe shkëputi Isën nga miqësia me Çezarin, ..."*[19]

D.Halikarnasit shkruan*:*

" ... më tepër u bënë të pasur ata që banonin në brigjet e Jonit, se për një kohë të gjatë ishin sundues të detit dhe i çonin perëndisë në Delf dhuratat më të mira ... Por, më vonë e lanë qytetin, pasi u sulmuan nga forca të mëdha nga barbarët fqinjë."[20]

Kolonitë greke që u ndërtuan në bregdetin e Adriatikut dhe të Jonit, patjetër që kanë pasur ndikimin e tyre në përhapjen e kulturës helene në zonat përreth tyre. Zhvillimi i këtyre qyteteve, si i Durrësit, Apollonisë, Bylisit, Orikut, Butrintit, etj., do të jetë shoqëruar edhe me hapjen e shkollave në gjuhën greke. Por, ky ndikim i kulturës dhe i gjuhës greke nuk ka mundur të shtrihej në zonat e thella, sidomos në ato përreth tyre, kodrinore apo malore. Ndaj, dhe historiani Tit Livi në një ndër librat e vet, shkruan:

"Qyteti dhe fshatrat iu dorëzuan disa me dëshirë, disa prej frikës, disa i pushtoi me forcë, të tjerët i gjeti të braktisur, meqenëse barbarët ishin larguar në malet e afërta".[21]

Dhe duke jetuar gjithmonë në këto troje, ku patën jetuar të parët e tyre, ata nuk e ndryshuan kurrë gjuhën. Në trojet, ku banojmë ne sot, në fillim kanë banuar pellazgët, të cilët për arsye të pozicionit të tyre gjeografik, të lidhur me yllin polar, u quajtën ilirë. Ky emërtim i këtyre fiseve që jetonin në këto territore, nuk u ndryshoi atyre as etninë dhe as gjuhën. Disa nga këto fise ilire, ata që jetojnë sot në territoret shqipfolës, u quajtën arbër. Ky emërtim i ri, përsëri nuk iu ndryshoi atyre as etninë dhe as gjuhën. Ata vazhduan të flasin po atë gjuhë të të parëve të vet, atë gjuhë që folën ilirët dhe pellazgët. Dhe kjo gjuhë, pellazgjishtja, e cila në varësi të ligjësive gjuhësore erdhi duke u zhvilluar deri në trajtën që ka shqipja sot.

Jo rastësisht, me vjetërsinë e popujve përkon dhe vjetërsia e gjuhëve përkatëse, që pas më shumë se 2000-3000 vjetëve historiografia dhe institute me zë evropiane (Institute në Danimarkë, Austri dhe

[18] *Po aty,*

[19] *Po aty,*

[20] *D. HALIKARNASI,*

[21] *Tit LIVI, Themelimi I Romës, fq. 33,*

Suedi) janë detyruar të pranojnë dhe të trumbetojnë skemën e mëposhtme (Fig.-9). Ndaj dhe Platoni, vjetërsinë e madhe të gjuhës pellazge, e pohon tërthorazi në Kratilin e tij, ku ai shkruan se[22]:

"…gjithçka që nuk e dimë nga gjuha dhe gjithçka që nuk e kuptojmë, fare mirë mund të jetë barbare, por gjithashtu fare mirë mund të duket si e tillë, për shkak të lashtësisë së saj shumë të madhe.



Figura 2. Pema e 63 gjuhëve Indo-Europiane.

[22] *PLATONI, Kratili,*

Fig. – 6 *Pema e 63 gjuhëve indo-evropiane, Shikoni me vëmendje: Gjuha, gjenet dhe vitet e lashtësisë, në çdo skemë profesionale ku paraqiten gjuhët indo-evropiane, gjuha shqipe figuron e para në trungun e saj dhe më e vjetra + 9000 vite lashtësi.*[23]

"RRËNJËT TONA"

[23] *Mirënjohje Institutit të gjuhëve Suedi, 1978, dhe Institutit të gjuhëve Austri, 1985*